



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 57

Prishtinë, më 05.09.2012, ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.07.2012;
3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së për sesionin vjeshtor;
4. Të ndryshme.

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.07.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 06.07.2012, i cili u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së për sesionin vjeshtor.

Kryetari i Komisionit- Në kuadër të Planit të Punës së Komisionit ai përmendi veprimet e marra në këtë drejtim, duke theksuar se në rrafshin legjislativ janë kryer të gjitha obligimet pasi për të gjitha ligjet që janë sjell në Komision janë shqyrtuar dhe janë aprovuar në seancë, tutje ai tha se në sferën e integriteteve evropiane janë kryer obligimet të paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komisioni për Integritete Evropiane.

Ndërsa për aspektin e mbikëqyrjes nga ana e Komisionit theksoi se vazhdon të bëhet dhe theksoi grupin punues që është i angazhuar për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit të IPK-së, ndërsa për mbikëqyrjen e financave publike ai shtoi se për këtë çështje ka realizuar një takim me përfaqësuesit e OSBE-së, të cilët kanë ofruar mbështetjen me një këshilltar për mbikëqyrjen financiare, për këtë qëllim është rënë dakord që në mbledhjen e radhës së Komisionit të ofrohet modeli i mundshëm në mënyrë që të mbikëqyret Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës dhe pastaj agjencitë e tjera të cilat mbikëqyren nga Komisioni. Në vazhdim fjalën ia kaloi Shpend Qamili.

Shpend Qamili (këshilltar nga OSCE)- Lidhur me mbikëqyrjen financiare tha se në javën e ardhshme do të përpilohet një plan i veprimit për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë me fokus të veçantë Departamenti i Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në kuadër të Policisë së Kosovës. Tutje ai tha se pas kërkesës për dokumentacione do të punohet në këtë drejtim dhe se me grupin punues i themeluar me vendim të Komisionit për mbikëqyrjen financiare do të bashkëpunohet.

Kryetari i Komisionit- Për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë, tha se grupi punues i formuar për këtë qëllim do të vazhdoj punën tutje dhe fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili.

Fatmir Xhelili- Për mbikëqyrjen financiare të institucioneve të sigurisë, ai tha se propozimi i ofruar nga OSBE-ja mund të plotësohet nga ana e anëtarëve të grupit punues, pasi qëllimi i këtij grupi nuk është të bëjë auditim në këto institucione. Tutje ai tha se qëllimi i mbikëqyrjes financiare duhet të bëhet në aspektin e përzgjedhjes së projekteve për politika investuese në segmentet e caktuara, nëse i janë përmbajtur planeve projektuese të planifikuara për shpenzime dhe investime kapitale dhe në infrastrukturë, nëse ka pasur alokime jo të ligjshme të mjeteve për investimet kapitale dhe arsyet pse ka

ndodhur kjo, nëse i janë përmbajtur investimeve në drejtim të kornizës afatmesme të shpenzimeve të planifikuara dhe nëse veprime të tilla janë barazuar me veprime eventuale në thesarin e shtetit në krahasim me ato mjete që janë tërhequr nga buxheti dhe nëse barazimi final është i njëjtë dhe nëse ky barazim është kualitativ dhe jo vetëm numerik duke përfunduar se ky duhet të jetë qëllimi i grupit punues.

Shpend Qamili- Për planin që do të ofrohet nga ana e OSBE-së për mbikëqyrjen financiare, ai tha se do të bëhet në koordinim me anëtarët e grupit punues të angazhuar për këtë çështje dhe se procesi do të jetë bashkëpunues duke parë mënyrën se a është arritur vlera për parat e paguara duke mos luajtur rolin e auditorit por pa përjashtuar ekspertizën e tyre, duke dalë kështu me rekomandime.

Kryetari i Komisionit- Nga ana e Komisionit ai tha se është rënë dakord që qasja monitoruese ndaj institucioneve të sigurisë të jetë si një ndihmesë duke ju dhënë rekomandime për të qenë më efikas në punën e tyre, ndërsa për ofrimin e planit nga ana e këshilltarit të OSBE-së ai tha se ofrohen modele për mbikëqyrjen dhe se në fund Komisioni merr vendimin përfundimtar.

Ndërsa referuar planin të punës së Komisionit, për vizitat në institucionet e sigurisë, duke qenë se disa nga këto vizita janë realizuar, për pjesën e mbetur është rënë dakord me nënkryetarin, z. Rezhep Selimi që të bëhet një plan për vizita të ndarë në afate, në mënyrë që deri në fund të vitit të realizohen vizita në institucionet që mbikëqyren nga Komisioni.

Rexhep Selimi- Marrë parasysh intensitetin e punës në Komision, ai tha se është e nevojshme që paralel me planin e punës së Komisionit të bëhet edhe një agjendë grafike për punët e Komisionit dhe kjo për të qenë më operacional me punët e Komisionit dhe se plani i punës së Komisionit mund të ndryshohet varësisht nga ndryshimi i intensitetit të punës.

Vjollca Krasniqi- Për planin e punës së Komisionit tha se të gjitha ligjet janë paraqitur në Komision janë proceduar me kohë ndërsa disa aktivitete të cilat janë në plan nuk janë realizuar akoma, siç është rasti me mos realizimin e vizitës në Akademinë Policore në Vushtri. Tutje propozoi që një vizitë në këtë institucion të realizohet në muajt e ardhshëm, gjithashtu theksoi se nuk është realizuar as vizita në Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe nuk është pranuar raport nga Ministria e Kulturës me rastin e sjelljes së disa qytetarëve në mënyrë vandale në objektet e trashëgimisë kulturore, prandaj konsideroi se duhet një angazhim me i madh për realizimin e tyre.

Fatmir Xhelili- Për planin e punës së Komisionit, ai tha se shumica e aktiviteteve të parapara në të janë realizuar dhe se aktivitete që nuk kanë mundur të realizohen mund të bartën në sezonin vjeshtor dhe konsideroi se është e nevojshme përcaktimin e një orari për vizitën në institucione të parapara në plan, në mënyrë që të përmbushet plotësisht.

Kryetari i Komisionit- Për realizimin e vizitave tha se do të bëhet skema grafike, në të cilën do të caktohen datat për vizitat e radhës dhe se deri në muajin dhjetor të realizohen të gjitha vizitat.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë të rendit të ditës, ai thotë se është ashtu siç u kërkuar nga z. Xhelili, që në këtë pikë të diskutohet për afatin kohor për inventarizimin e dëshmive që është kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, dhe për këtë fjalën ia kaloi z. Fatmir Xhelili.

Fatmir Xhelili- Për institucionet që mbikëqyren nga Komisioni, ai tha se duhet të insistohet që për procesin e inventarizimit në dhomat e dëshmive të ofrohet një përgjigjeje me shkrim dhe të ofrohet një përgjigjeje nëse kjo ka ndodhur, nëse ka mospërputhje mes asaj që ka qenë e evidentuar në librat e evidencës dhe fakteve reale të gjetura gjatë regjistrimeve eventuale.

Tutje ai shtoi se duhet të shihet nëse regjistri i inventarizimit është në përputhje me regjistrin e prokurorisë për provat që ruhen në dhomat e dëshmive në Policinë e Kosovës dhe se përgjigja nga ana e tyre e ndalon mundësinë për manipulime në të ardhmen, duke bërë kështu që masat e sigurisë të jenë esenciale dhe zyrtarët policor të jenë më të përgjegjshëm.

Gjithashtu ai tha se të gjitha rekomandimet e dhëna nga Komisioni për institucionet e sigurisë, duhet parë nëse ato rekomandime janë realizuar dhe në rast se nuk janë realizuar duhet ditur arsyeja dhe se kjo do të bënte që Komisioni të ushtroj funksionin për të cilin është themeluar.

Kryetari i Komisionit- Për raportimin e institucioneve që mbikëqyr Komisioni, ai tha se një raport nga Ministria e Punëve të Brendshme i është paraqitur Komisionit pas kërkesës dhe se në raport është thënë për masat e ndërmarra masat për krijimin e grupeve punuese për procesin e inventarizimit në dhomën e dëshmive, ndërsa raporti përfundimtar nuk është ofruar akoma. Tutje ai tha se për këtë qëllim duhet dërguar një shkresë Ministrisë së Punëve të Brendshme për hapat e ndërmarra dhe një raport përfundimtar.

Rexhep Selimi- Për procesin e inventarizimit në dhomat e dëshmive, ai tha se kërkesa për një afat kohor nuk është e arsyeshme pasi duhet marrë në konsideratë edhe angazhimet e tyre, por mos përcaktimi i afatit nuk nënkupton mos përgjigjeje në këtë çështje. Në vazhdim ai tha se pajtohet me z. Xhelili, që tashmë të ofrohet një raport nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, prandaj konsideroi se është koha për përcaktimin e një afati për dhënien e rezultateve konkrete.

Kryetari i Komisionit- Në vazhdim të kësaj pike, ai diskutoi për çështjen e zjarreve që ka përfshirë disa territore të vendit dhe njoftoi për raportin e marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti i emergjencave. Tutje për këtë raport ai tha se përmban të dhëna që tregojnë gjendjen faktike me tepër se sa veprimet e ndërmarra nga institucionet e Kosovës për të qenë më efikas, gjithashtu falënderoi FSK-në dhe zjarrfikësit për angazhimin e tyre, dhe se sipas tij institucionet e tjera përgjegjëse kanë qenë më pak pjesëmarrëse dhe se KFOR-i është deklaruar që nuk ka pasur kapacitet për të reaguar.

Tutje ai njoftoi se një Komision në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka bërë vlerësimin e situatës dhe ka konstatuar se ka djegie të

qëllimshme . Për këtë qëllim ai tha se nëse nga anëtarët ka propozime për Departamentin e emergjencave dhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjithashtu theksoi se duhet drejtuar një shkresë po kësaj Ministrie që të ketë ngritje të fondeve emergjentë për komunat.

Rexhep Selimi- Për gjendjen e zjarreve në Kosovë, ai tha se mbështet angazhimin e madh të FSK-së në këtë situatë, gjithashtu shtroi çështjen nëse FSK-ja gjithmonë duhet të reagoj në situata emergjente dhe se theksoi angazhimin e dobët të departamenteve të emergjencave të nivelit komunal dhe qendror, dhe se angazhimi i tre në çdo situatë nuk i përgjigjet detyrave të tyre, pasi FSK-ja konsiderohet ushtri e Republikës së Kosovës. Në vazhdim ai tha se duhet parë ligjshmëria e kërkesës nëse FSK-ja duhet të reagojë apo jo, pasi sipas tij FSK-ja do duhej të ishte mekanizmi i fundit për reagim.

Fatmir Xhelili- Për situatën e zjarreve, ai tha se ka qenë e rënduar, tutje përmendi angazhimin e zjarrfikësve në këtë situatë dhe përmendi njësit e zjarrfikësve të Gjakovës, Prizrenit dhe të Gjakovës si njësi elite, që punojnë me standarde evropiane dhe se ata kanë vepruar sipas planit të reagimit kombëtarë duke reagojë të parët.

Tutje ai tha se në Kosovë është e përcaktuar mënyrë e reagimit të secilit mekanizëm, dhe se ka një ndarje të shkallëve të rrezikshmërisë, nga niveli i parë deri në nivelin gjashtë dhe angazhimi i segmenteve të caktuara kanë kushtet e angazhimit dhe se jo gjithmonë FSK-ja reagon e para. Në vazhdim ai tha se duhet mbështetur segmenti i zjarrfikësve, në mënyrë që të pajisen me mjete moderne, duke qenë se ata janë profesionist dhe të përgatitur.

Goran Marinković- Për çështjen e zjarreve ai tha se me këtë gjë janë ballafaquar edhe shtetet e rajonit, ndërsa për aspektin se kush duhet të jetë i pari në vendin e ngjarjes për fikjen e zjarreve , ai tha se as FSK-ja dhe as zjarrfikësit nuk kanë reagojë me kohë. Tutje ai tha se për ternin e përfshirë nga zjarret në të cilin jeton edhe komuniteti serb, nuk është interesuar askush dhe se nuk dihet nëse kjo gjë ka ndodhur për baza etnike. Sipas tij nga ajo çfarë është transmetuar nga qytetarët e kësaj zone, askush nuk është interesuar për pengimin e zjarrit duke qenë se zjarri ka arritur deri në 150m afër shtëpive.

Në vazhdim ai tha se të rrezikuar kanë qenë qytetarët, dhe se nëse bëhet propozime nga ana e Komisionit duhet të merret parasysh që të bëhet profesionalizmi i njërive të zjarrfikësve për të qenë më efektiv, Tutje ai tha se si përfaqësues i komunitetit serb dhe si anëtar i Komisionit, ngriti çështjen se pse nuk është reagojë me kohë në ato zona, gjithashtu kërkoi që në sezonet e ardhshme të kihet kujdes që në situata të tilla të reagojë me kohë.

Fatmir Xhelili- Me konstatimet e z. Marinković, ai tha se pajtohet me disa prej tyre, ndërsa sa i përket mos reagimit në situatën e zjarreve në disa rajone nuk është bërë mbi baza etnike, pasi kapacitetet e njërive janë ato që paraqiten dhe se territori në të cilin kanë ndodhur zjarret nuk ka lënë hapësirë për të reagojë, pasi duhet të bëhet ndërtimi i rrugëve malore dhe se për këtë arsye reagimi ka qenë i pamundur.

Goran Marinković- Për reagimin për zjarret e shkaktuara, ai tha se ai ka përcjell shqetësimet e qytetarëve të kësaj zone sipas të cilëve nuk është reaguar me kohë në këtë zonë.

Rexhep Selimi- Pajtohem me reagimin e z. Marinković që FSK-ja nuk ka reaguar në mënyrë “profesionale”, pasi ky nuk është misioni i saj, ndërsa sa i përket angazhimit të FSK-sa, ai tha se ajo duhet të angazhohet e fundit në situata të tilla, por për angazhimin e ushtrisë duhet shpall gjendje e jashtëzakonshme. Tutje ai tha se kapacitete ekzistuese komunale dhe qendrore për menaxhimin e emergjencave nuk janë në nivelin e duhur, por reagimi i tyre duhet të jetë më aktiv, rritjen e nivelit të profesionalizmit, pasi FSK-ja duhet të përqendrohet në nivele të tjera.

Goran Marinković- Tha se mandati i FSK-së dihet se cili është dhe se ky mandat nuk ka ndryshuar akoma.

Rasim Demiri- Për situatën e zjarreve ai tha se në mbledhjen e kaluar ka raportuar për një situatë të tillë për zjarret në zonën e Koretnikut. Tutje ai njoftoi se nga mbledhja e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në të cilin ai bën pjesë, është ftuar Ministri, z. Blerand Stavileci për raportim, gjithashtu ai theksoi se zjarret kanë përfshirë të gjitha vendet e rajonit dhe se nuk mund ti adresohet vetëm Qeverisë një përgjegjësi e tillë. Në vazhdim ai tha se nga Ministri ka kërkuar kompensimin e dëmeve për atë përqindje të pronës private të dëmtuar që është afër 30%, si dhe është kërkuar që menaxhimi i situatave emergjente tu kalojë në kompetencë komunave, ndërsa sa i përket reagimit të FSK-së, ai tha se kanë reaguar me profesionalizëm.

Kryetari i Komisionit- Për situatën e zjarreve, ai tha se nga të gjithë anëtarët e Komisionit u pohua që nuk ka pasur efikasitet dhe kjo në mungesë të mjeteve, ndërsa reagimet nga ana e FSK-së dhe zjarrëfiksësve kanë qenë aktive në të gjitha pjesët ku kanë mundur të ndërhyjnë dhe se nga informatat që janë dhënë nuk ka bazë tendencioze mbi baza etnike, dhe se reagimi është varur nga mundësitë dhe përgatitjet. Për këtë arsye, ai propozoi se si Komision duhet bërë disa rekomandime Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të rritur efikasitetin dhe se për komunat të ndahet buxhet i veçantë për raste emergjente.

Fatmir Xhelili- Për situatën e zjarreve ai tha se, zjarrëvëniet e qëllimshme duhet të trajtohen si vepër penale, të cila synim kanë përfitimet materiale nga ana e kompanive që përfitojnë nga një situatë e tillë.

Kryetari i Komisionit- Për çështjen në fjalë, ai propozoi që në përbërje të tij, z. Fatmir Xhelili, z. Rexhep Selimi, të përpilohet një rekomandim drejtuar Qeverisë, për të obliguar për disa veprime që duhet të ndërmerren për evitimin e pasojave në të ardhmen për menaxhimin e situatës së zjarreve.

Tutje njoftoi se vizita studimore në Austri mund të realizohet në muajin tetor, ndërsa për vizitën në Turqi për shkak të angazhimeve për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë nuk do të mund të realizohet.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi